



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 135/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Therandë, paraqitur kundër subjektit Nisma për Kosovën dega në Therandë, për shkak të vendosjes së posterëve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Therandë kështu që Nisma për Kosovën, dega Therandë i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 04.06.2014, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 04.06.2014, në ora 11:00 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë vërejtur se në rrugën – Brigada 123 – qyteti Therandë ishte vendosur poster i subjektit politik Nisma për Kosovën në shenjë të komunikacionit, objekt i cili është në pronësi publike Sipas ankesës, është bërë shkelja e dispozitës së nenit 4.1 pika (b) të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013 vendosja e posterëve në objekte publike përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre. Sipas kësaj, subjekti Nisma për Kosovën me vendosjen e posterit në shenjë të komunikacionit që është objekt publik ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika (b) të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës ka ofruar një fotografi .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi- Nismën për Kosovën, me datën 05.06.2014, dhe i ka dhënë Urdhër për të Ndërmarrë masat Përmirësuese lidhur me ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankesës deri më datë 06.06.2014 deri në ora 10:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë të kërkuar nga subjekti Nisma për Kosovën në të cilën thekson se vendosja e posterit në shenjë të komunikacionit të subjektit politik Nisma për Kosovën nuk është bërë nga strukturat e subjektit të tyre, vendosja është bërë nga qytetar apo individ të paidentifikuar. Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Nisma për Kosovën konfirmon se në momentin e njoftimit për ankesë ka kontaktuar Shtabin Zgjedhor për

Komunën e Therandës për të bërë heqjen e këtij postëri të parashtruar në ankesë dhe në cilësinë e provës, përgjigjes ja kanë bashkangjitur fotografinë në të cilën dëshmohet veprimi i largimit të posterit të vendosur në shenjë të komunikacionit në qytetin e Therandës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i subjektit Nisma për Kosovën është vendosur në shenjë publike të trafikut në Komunën e Therandës, veprim ky i cili është në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika (b) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. që ndalon vendosjen e posterëve në shenjat publike të trafikut.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;

Andaj duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i konstatoi se subjekti politik Nisma për Kosovën, në këtë rast ka thyer Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët e tyre dhe duke u bazuar në shkallën dhe peshën e shkeljes për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë, me qenë se subjekti politik në fjalë merë pjesë për herë të parë në Zgjedhje si subjekt politik, dhe se heqja e posterit sipas urdhrit të PZAP-it është realizuar kjo merret si rrethanë lehtësuese në shqiptimin e gjobës . Andaj në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it dhe nenit 120 paragrafi I pika (c) dhe 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 135/2014 më datën 06.06.2014.

Kryesuesi Panelit
Xhevdet Abazi



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*